

**Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj**

**Pasqyrat Financiare  
me dhe per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2018**

## RAPORT I AUDITUESVE TE PAVARUR

Drejtuar: Asamblese se Aksionereve te Shoqerise  
"BRUNEL ENERGY EUROPE B.V. Dege e Shoqerise se Huaj"

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "BRUNEL ENERGY EUROPE B.V. Dege e Shoqerise se Huaj", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2018, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (*Kodi i BSNEPK*) së bashku me kërkesat etike dhe ligjore që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

Ne nuk kemi përcaktuar ndonjë çështje si çështje kryesore të auditimit që duhet të komunikohen në raportin tonë të auditimit.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.


Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.



**Adresa:**

**Lagjja: Sul Papri, Rr: 25 Nentori, Nd3, H13, Ap 16,  
Elbasan, ALBANIA**



**Adresa:**

**Lagjja: 28 Nëntori, Rr: Abdyl Frashëri, Nr 28,  
Elbasan, ALBANIA**

**Date: 29 Mars 2019**

<b>PERMBAJTJA:</b>	<b>FAQE</b>
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA</b>	
<b>GJITHEPERFSHIRESE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE</b>	<b>6</b>
<b>SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>7-22</b>

**Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj****Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2018***(Shumat ne LEK)*

	Shenime	Me 31 dhjetor 2018	Me 31 dhjetor 2017
<b>Aktive</b>			
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		-	-
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>			
Aktive te tjera	5	1,942,772	2,057,537
Llogari te arketueshme	6	54,015,296	22,666,209
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	7	17,239,427	95,105,543
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>73,197,495</b>	<b>119,829,289</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>73,197,495</b>	<b>119,829,289</b>
<b>Kapitali dhe detyrime</b>			
<b>Kapitali</b>			
Humbja e akumuluar		(14,288,065)	(10,629,070)
Fitimi (Humbja) e vitit		7,120,619	(3,658,995)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>(7,167,446)</b>	<b>(14,288,065)</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Fonde te marra nga Shoqeria Meme	8	43,207,300	113,250,253
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>43,207,300</b>	<b>113,250,253</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Detyrime tatimore	9	4,384,268	5,063,338
Tatimi mbi fitimin i pagueshem	17	461,076	-
Shpenzime te perllogaritura	10	1,215,811	731,225
Llogari te pagueshme	11	18,745,910	7,256,057
Llogari te pagueshme ndaj punonjesve	12	12,350,576	7,816,481
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>37,157,641</b>	<b>20,867,101</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>80,364,941</b>	<b>134,117,354</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe i kapitalit</b>		<b>73,197,495</b>	<b>119,829,289</b>

Keto Pasqyra Financiare u miratuan dhe u nenshkruan nga perfaqesuesi ligjor i Shoqerise Brunel Energy Europe B.V- Dege e Shoqerise se Huaj me 29.03.2019:

  
Perfaqesuesi Ligjor

**Peter Aleksander De Laape**

*Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22 te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

**Brunel Energy Europe B.V.**  
Dege e shoqerise se huaj  
Nr. 51816004 Q  
Adresa: Rr Elbasan, 7000, Nr. 1, Kati. 2  
Tiranë - Albania

**Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj****Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te tjera Gjitheperfshirese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018***(Shumat ne LEK)*

		<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</b>	<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017</b>
<b>Te ardhurat</b>			
Te ardhura nga sherbimet		167,316,370	183,197,245
Te ardhura te tjera		-	14,710
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>13</b>	<b>167,316,370</b>	<b>183,211,955</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime personeli	14	(140,215,403)	(151,504,300)
Shpenzime operative	15	(24,444,777)	(32,769,948)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(164,660,180)</b>	<b>(184,274,248)</b>
<b>Fitimi nga aktiviteti operacional</b>		<b>2,656,190</b>	<b>(1,062,293)</b>
<b>Fitim (Humbje) nga kurset e kembimit</b>			
Fitimi (Humbja) nga kurset e kembimit	16	6,563,141	(1,900,784)
<b>Fitimi (Humbja) neto nga kurset e kembimit</b>		<b>6,563,141</b>	<b>(1,900,784)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>9,219,331</b>	<b>(2,963,077)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	2,098,712	695,918
<b>Fitim neto per vitin</b>		<b>7,120,619</b>	<b>(3,658,995)</b>
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese per vitin		-	-
<b>Totali i te ardhurave gjitheperfshire per vitin</b>		<b>7,120,619</b>	<b>(3,658,995)</b>

*Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te tjera Gjitheperfshirese duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

**Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj****Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018***(Shumat ne LEK)*

	<b>Humbja e akumuluar</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja me 1 janar 2017</b>	<b>(10,629,070)</b>	<b>(10,629,070)</b>
Humbja neto e vitit financiar	(3,658,995)	(3,658,995)
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2017</b>	<b>(14,288,065)</b>	<b>(14,288,065)</b>
<b>Gjendja me 1 janar 2018</b>	<b>(14,288,065)</b>	<b>(14,288,065)</b>
Fitimi neto i vitit financiar	7,120,619	7,120,619
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2018</b>	<b>(7,167,446)</b>	<b>(7,167,446)</b>

*Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

**Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se Huaj**

**Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018**

*(Shumat ne LEK)*

Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017
<b>Flukset e mjeteve monetare gjeneruar nga (te perdorura ne) veprimtarite e shfrytezimit</b>		
Fitimi para tatimit	9,219,331	(2,963,077)
<b>Ndryshimet ne kapitalin punues:</b>		
Renie ne aktive te tjera	5	1,752,403
Rritje ne llogarite e arketueshme	6	(31,349,087)
Renie ne detyrime tatimore	9	(679,070)
Rritje ne tatimin mbi fitimin e pagueshem	17	461,076
Rritje ne shpenzime te perlllogaritura	10	484,586
Rritje (renie) ne llogarite e pagueshme	11	9,391,141
Rritje (renie) ne llogarite e pagueshme ndaj punonjesve	12	4,534,095
<b>Paraja e perdorur ne veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>(6,185,525)</b>	<b>(29,283,432)</b>
Tatimi mbi fitimin i paguar	(1,637,636)	(695,918)
<b>Flukset e mjeteve monetare te perdorura ne veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>(7,823,161)</b>	<b>(29,979,350)</b>
<b>Flukset e mjeteve monetare gjeneruar nga (te perdorura ne) veprimtarite e investimit</b>		
<b>Flukset e mjeteve monetare te perdorura ne veprimtarite e investimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Flukset e mjeteve monetare gjeneruar nga (te perdorura ne) veprimtarite e financimit</b>		
Fonde te dhena Shoqerise Meme	8	(70,042,953)
<b>Flukset e mjeteve monetare te perdorura ne veprimtarite e financimit</b>	<b>(70,042,953)</b>	<b>(145,777,318)</b>
<b>Renie neto e mjeteve monetare</b>	<b>(77,866,114)</b>	<b>(175,756,668)</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente te tyre ne 1 janar 2018</b>	<b>7</b>	<b>95,105,542</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente te tyre ne 31 dhjetor 2018</b>	<b>7</b>	<b>17,239,427</b>

*Pasqyra e flukseve te mjeteve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 22, te cilat jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*



## **Brunel Energy Europe BV - Dege e Shoqerise se Huaj**

### **Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018**

*(Shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)*

#### **1. INFORMACION I PERGJITHSHEM**

Brunel Energy Europe BV – Dege e Shoqerise se huaj (referuar ne vijim si “Dega”) eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne daten 18 maj 2015, si dege e shoqerise se huaj, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar. Perfaqesues ligjore te Deges jane Z. Johan Hardy Flohr dhe Z. Peter Aleksander De Laat, te dy shtetas hollandez. Shoqeria Meme eshte Brunel Energy Europe B.V., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara me kapital ne shumen 18,000 Euro, e themeluar ne Hollande me 20 shkurt 2003.

Objekt i veprimtarise se Deges eshte te ofroje sherbime dhe keshillime per sipermarrjet industriale, vecanerisht sipermarrjet qe ushtrojne veprimtari ne fushen e industrise se vajit dhe gazit, kimise, industrise petrokimike dhe industrise se energjise.

Bazuar ne nenin 41 te Ligjit “Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar”, Shoqeria detyrohet te kryeje auditimin ligjor te Pasqyrave Financiare, perpara publikimit te tyre.

Gjate vitit 2018, Dega ka pasur marredhenie kontraktuale me Trans Adriatic Pipeline AG, Dega ne Shqiperi (ketej e tutje referuar si “TAP”).

Dega me 31 dhjetor 2018 ka deklaruar mesatarisht 9 punemarres (31 dhjetor 2017: 5 punemarres).

#### **2. BAZA E PERGATITJES**

##### **(a) Deklarata e perputhshmerise se pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

##### **(b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

##### **(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Shumat ne pasqyrat financiare jane te shprehura ne monedhen shqiptare Lek (LEK), qe eshte edhe monedha funksionale e Deges.

##### **(d) Vijimesia**

Drejtimi i ka pergatitur keto pasqyra ne baze te parimit te vijimesise. Ne vendosjen e ketij gjykimi, drejtimi ka konsideruar pozicionin financiar te Deges, qellimet aktuale, perfitueshmerine e operacioneve dhe aksesin ne burimet dhe aftesite financiare te Shoqerise Meme per ta mbeshtetur me burime financiare per 12 muajt e ardhshem.

## **2. BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)**

### **ZBATIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF) TE REJA DHE TE RISHIKUARA**

#### **(e) Standarde dhe interpretime ne fuqi per periudhen raportuese**

Ndryshimet e meposhtme te standardeve ekzistuese te publikuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare jane ne fuqi per periudhen raportuese:

- **SNRF 9 "Instrumentet financiare"** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me dhe pas dates 1 janar 2018);
- **SNRF 15 "Te ardhurat nga kontratat me klientet"** dhe ndryshime te metejshme (efektiv me ose pas dates 1 janar 2018);
- **Ndryshimet ne SNRF 2 "Pagesat bazuar ne Aksione"**. Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve te pagesave me baze aksionet (efektiv me ose pas dates 1 janar 2018);
- **Ndryshimet ne SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"**. Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat financiare" me SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" (ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentat financiare" eshte zbatuar per here te pare);
- **Ndryshimet ne SNK 40 "Investime ne Aktivete Materiale Afatgjata"**. Transferimet e aktiveve materiale afatgjata te investuara (efektive me ose pas 1 janarit 2018);
- **Ndryshime ne SNRF 1 dhe SNK 28 si pasoje e "Permiresimeve te SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i permiresimit vjetor te SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me nje pikepamje per te eliminuar mosperputhjet dhe per te qartesuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do te jene te zbatueshme per periudhat vjetore duke filluar ne ose pas dates 1 janar 2018);
- **KIRFN 22 "Transaksionet ne valute dhe Konsideratat ne avance"** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2018).

Zbatimi i ketyre ndryshimeve ne standardet ekzistuese nuk ka ndikuar ne politikat kontabel te Deges.

#### **(f) Standarde dhe interpretime ne publikim, por akoma jo efektive**

Ne daten e miratimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet e reja te meposhtme, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- **SNRF 16 "Qirate"** (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 janar 2019);
- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"** (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas dates 1 janar 2021);
- **Ndryshimet ne SNRF 9 "Instrumentat Financiare"**. Vecorite e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv me ose pas dates 1 janar 2019);
- **Ndryshime ne SNRF 10 "Pasqyrat financiare te konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime ne pjesemarrje dhe siperemarrje te perbashketa"**. Shitja apo kontributi i pasurive ndermjet nje

## **2. BAZA E PERGATITJES (VAZHDIM)**

### **(e) Standarde dhe interpretime ne publikim, por akoma jo efektive (vazhdim)**

investitori dhe bashkepunatori te tij ose siper marrje te perbashket (hyrja ne fuqi eshte shtyre per nje kohe te papercaktuar deri kur te mbaroje projekti kerkimore mbi metodologjine e aktiveve);

- **Ndryshimet ne SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabel, Ndryshimet ne Vleresimet Kontabel dhe Gabimet".** Perkufizimi i Materialit (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2020);
- **Ndryshimet ne SNK 19 "Perfitimet e punonjesve".** Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019);
- **Ndryshimet ne SNK 28 "Investimet ne pjesemarrje dhe siper marrjet e perbashketa".** Interesa afatgjate ne Pjesemarrje dhe Ndermarrje te Perbashketa (efektiv me ose pas dates 1 janar 2019);
- **Ndryshimet ne standarde te ndryshme per shkak te "Permiresimeve te SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** qe rezultojne nga projekti vjetor i permiresimit te SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qellim heqjen e mosperputhjeve dhe qartesimin e formulimit efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019);
- **Ndryshimet ne Referencat ne Kuadrin Konceptual ne Standardet e SNRF** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2020);
- **KIFRN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi te Ardhurat"** (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 janarit 2019).

Dega ka zgjedhur te mos zbatoje keto standarde te reja, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja perpara dates kur behen efektive. Shoqeria parashikon qe zbatimi i ketyre standardeve, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do te kene ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise ne periudhen e zbatimit fillestar.

## **3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL**

### **(a) Aktivet afatgjata materiale**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Dega nuk ka patur aktive afatgjata materiale per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018. Megjithate, sipas politikave kontabel qe ajo zbaton zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvleresimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi (shih politiken kontabel 3(c)). Kur pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si elemente te vecanta te aktiveve afatgjata.

#### *(ii) Kostot vijuese*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet me vleren e mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te ardhme qe i atribuohen atij elementi t'i perkasin Deges, dhe nese kostoja e tij mund te matet me besueshmeri.

### **3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **(a) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

##### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje gjate jetes se dobishme te aktiveve. Metodot e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nese eshte e konsiderueshme) rivleresohen ne daten e raportimit.

#### **(b) Inventaret**

Dega nuk ka mbajtur inventar gjate vitit 2018. Megjithate, sipas politikave kontabel qe ajo zbaton inventaret maten me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kosto percaktohet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme eshte çmimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit minus kostot e vleresuara per perfundimin dhe realizimin e shitjes. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renies ne vlere te inventareve deri ne vleren e realizueshme neto si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

#### **(c) Renia ne vlere e aktiveve jofinanciare**

Ne çdo date raportimi Dega rishikon vleren kontabel te aktiveve jofinanciare, pervec inventarit dhe aktiveve tatimore te shtyra, per te percaktuar nese ka tregues per reniet e vleres. Nese ka tregues te tille, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitet ne menyre qe te percaktohet renia ne vlere. Vlera e rikuperueshme e nje aktiviteti ose njesise gjeneruese te parase eshte vlera me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte minus koston e shitjes.

Per percaktimin e vleres ne perdorim, skontohen rrjedhat e ardhshme te parase duke perdorur normen e skontimit para tatimit, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqeve specifike te aktivitetit. Per qellime te testimit te renies ne vlere, aktivitet grupohen se bashku ne grupin me te vogel te tyre i cili gjeneron rrjedha parash nga perdorimi i vazhdueshem i tyre dhe qe jane te pavarura nga rrjedhat e parase te aktiveve ose grupeve te tjera te aktiveve ("njesia gjeneruese e parase").

Nje humbje nga renia ne vlere njihet nese vlera e mbetur e nje aktiviteti apo e njesise se tij gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga renia ne vlere njihen ne pasqyren e fitimit ose humbjes. Humbjet nga renia ne vlere, qe jane njohur ne periudhat e meparshme, vleresohen ne çdo date raportimi nese ka evidence qe humbja eshte ulur ose nuk ekziston me.

#### **(d) Instrumentet financiare**

Dega mban vetem instrumente financiare joderivative, qe perfshijne llogari te arketueshme, aktive te tjera, mjete monetare dhe ekuivalente me to, fonde te marra nga Shoqeria Meme dhe llogari te pagueshme. Instrumentet financiare joderivative jane matur fillimisht me vleren e drejte plus kostot e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejte me pervesimin e tyre.

### **3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **(d) Instrumentet financiare (vazhdim)**

Nje instrument financiar njihet ne rast se Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat kontraktuale te Deges ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojne ose nese Dega i transferon aktivitetin financiar nje pale tjetere, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te nje aktiviteti financiar jane regjistruar ne daten e tregtimit, p.sh. daten ne te cilen Dega zotohet te bleje ose te shese aktivitetin. Detyrimet financiare nuk njihen nese detyrimet e Deges te detajuara ne kontrate mbarojne, jane shlyer ose jane anuluar.

Pas njohjes fillestare instrumentet financiare joderivative vleresohen si me poshte:

#### *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat monetare te mbajtura ne llogari rrjedhese ne banka, te cilat jane objekt i nje rreziku jo domethenes te ndryshimeve ne vlere dhe perdoren nga Dega ne administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

#### *Llogari te arketueshme*

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te paksuara me humbjet nga renia ne vlere.

#### *Llogari te pagueshme*

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te amortizuar.

#### *Fondet nga Shoqeria Meme*

Dega ka marre financime (fonde) nga Shoqeria Meme, te cilat njihen fillimisht me vleren e drejte. Huamarrjet mbarten ne vijim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga renia ne vlere.

#### *Te tjera*

Instrumenta financiare te tjere joderivative maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga renia ne vlere.

Metoda e interesit efektiv eshte nje metode per llogaritjen e koston se amortizuar te nje aktiviteti ose detyrimi financiar dhe per shperndarjen e te ardhurave ose shpenzimeve te interesit pergjate periudhes perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe skanton plotesisht pagesat e ardhshme te vleresuara pergjate jetes se pritshme te instrumentit financiar ose, kur eshte e pershtatshme, pergjate nje periudhe me te shkurter me vleren e mbartur neto te aktivitetit ose detyrimit financiar.

Kontabiliteti per te ardhurat dhe shpenzimet financiare shtjellohet ne politiken kontabel 3(g).

#### *Renia ne vlere e aktivitetit financiar*

Nje aktiviteti financiar konsiderohet te jete i zhvleresuar nese nje fakt objektiv tregon qe nje ose me shume ngjarje kane patur nje ndikim negativ ne flukset e ardhshme monetare te aktivitetit. Nje humbje

### **3. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **(d) Instrumentet financiare (vazhdim)**

